



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:262561

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06153858

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0545-A0001

Paditësi

O N nga Prizreni.

Kundër:

E paditura/Ankuese

N.SH. NGLB “Kosova”, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Murat Hulaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-22-0415, të datës 11 shtator 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-22-0415, i datës 11 shtator 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 28 qershor 2013, ankuesi ka parashtruar një ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ029-0172 i datës 28 maj 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 575.08 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se nga lista e pagave për 12 muajt e fundit para datës së privatizimit e paraqitur nga menaxhmenti i N.SH-së nuk pasqyrohet ndonjë pagesë e kryer ndaj parashtruesit të kërkesës dhe AL kishte vërejtur se parashtruesi i kërkesës nuk ishte punëtor aktiv i N.SH-së. Në ankesë paditësi kishte theksuar se të gjithë punëtorët e N.SH kanë mbetur pa punë për shkak se N.SH në fjalë ishte privatizuar. Gjithashtu i njëjti kishte propozuar që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar dhe t'i njihet e drejta për dëmshpërblim në shumën prej 575.euro për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Ankesës i kishte bashkëngjitur: njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, kopjen e librezës së punës, një njoftim nga paditësi për AKP-në për iniciimin e procedurës gjyqësore ndaj vendimit të AL-së si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ029-0172 i datës 28 maj 2013.

Me datë 21 dhjetor 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se ekzistenca e pretendimeve të parashtruesit nuk është e bazuar në ligj dhe prova dhe pala kundërshtare thekson se edhe lartësia e dëmit të pretenduar nuk është e bazuar në asnjë dokument të besueshëm që do të provonte se N.SH i detyrohet parashtruesit ndonjë shumë. Gjithashtu, parashtruesi nuk ka saktësuar asnjë detaj lidhur me funksionin e tij pranë N.SH-së, oraret e punës dhe çfarë do të dëshmonte se ai vërtetë ka qenë duke punuar në N.SH dhe është pushuar nga puna në momentin e privatizimit. Andaj, duke u bazuar në këto që u theksuar i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur komulativin e rrogave të papaguara për muajt janar-shkurt 2005 si dhe kërkesën për emërim të anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 28 shtator 2020, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-13-1053 kishte aprovuar si të bazuar kërkesën për rishikim të paditësit duke shfuqizuar vendimin e ankimuar të AL-së dhe duke obliguar AL-në që të rishqyrtoj kërkesën kreditore të parashtruesit të kërkesës.

Me datë 23 tetor 2020, AKP-ja kishte paraqitur një ankesë në DHPGJS ndaj Aktvendimit të shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV-13-1053 të datës 28 shtator 2020 duke i propozuar gjykatës që të ndryshoj Aktvendimin e ankimuar dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 8 dhjetor 2022, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me Aktvendimin AC-I-20-0467 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e AKP-së duke anuluar Aktvendimin e ankimuar të shkallës së parë ashtu që kishte dërguar për rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së lëndën C-IV-13-1053 të datës 28 shtator 2020. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi ishte theksuar se shkalla e parë e DHPGJS-së me të drejtë kishte konstatuar disa mangësi në vendimmarrjen e AL të AKP-së por përkundër këtij fakti ajo nuk mund të kthej këtë çështje në rigjykim tek AL sepse një gjë e tillë nuk është e paraparë me dispozitat ligjore në zbatim por edhe për faktin se një autoritet i tillë tashmë nuk është funksional.

Me datë 11 shtator 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-22-0415 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit, duke obliguar AL-në që ankuesit në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës t'i paguaj shumën prej 575.08 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se njoftimi, librezja e punës dhe lista e punëtorëve e publikuar nga AKM, argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor aktiv i N.SH-së deri në datën e privatizimit të saj me datë 24 shkurt 2005, respektivisht se ankuesi ishte punëtor i regjistruar me të drejtë legjitime pranë ndërmarrjes në fjalë me rastin e përfitimit të një pjese të të hyrave të 20% nga privatizimi i ndërmarrjes. AKP asnjëherë nuk e kishte kundërshtuar shumën e kërkuar nga ankuesi, përkatësisht nuk e kishte argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do t'i mohohej e drejta në kompensim. Andaj, gjykata në fund kishte konstatuar se ankuesi ka arritur të dëshmoj të drejtën në kompensim në shumën prej 575.08 euro.

Me datë 3 tetor 2023, e paditura kishte paraqitur një ankesë ndaj Aktgjykimit C-IV-22-0415 të datës 11 shtator 2023, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe duke vërtetuar këtë të fundit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë dy afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëj me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëj me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse

një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Tutje, pala kundërshtare sqaron gjykatën se njoftimi që i referohet parashtruesi e informon atë se ai ka të drejtë të parashtrorj kërkesën pranë AKP-së dhe se kërkesa të tilla do të shqyrtohen në likuidim. Duke injoruar plotësisht parashtrësën e palës kundërshtare dhe argumentet e saj në mbrojtje, Aktvendimi nuk përmbushë aspak detyrimin e shprehur në nenin 54 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posacme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtrësave të prezantuara gjatë procedurës. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 31 korrik 2024, paditësi e kishte pranuar ankesën e të paditurës mirëpo nuk kishte paraqitur përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 575.08 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se AL kishte vlerësuar se parashtruesi i kërkesës nuk ishte punëtor aktiv i N.SH-së në kohën e privatizimit të saj.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur këto prova: njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës se paditësit, kopjen e librezës së punës, një njoftim nga paditësi për AKP-në për iniciimin e procedurës gjyqësore ndaj vendimit të AL-së si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ029-0172 i datës 28 maj 2013.

Shkalla e parë e DHPGJS-së, në rigjykim, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 575.08 euro.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-së kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kolegji i Apelit vëren se nga kopja e librezës së punës së paditësit shihet që i njëjti ka ofruar shërbime pune për N.SH deri në ditën e privatizimit të saj dhe atë me datë 24 shkurt 2005, ditë kjo kur edhe i është mbyllur librezja e punës.

Pastaj, nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, i cili është i bashkëngjitur në prova në shkresa të lëndës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, me datë 24 shkurt 2005 kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë. Ky njoftim në përmbajtjen e tij thekson se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*.

Prandaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit që i është bërë, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit për dorëzimin e kërkesave kishte paraqitur kërkesën për kompensim në emër të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se ashtu siç me të drejtë thekson shkalla e parë, e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësit nuk i takon dëmshpërblimi i lartcekur.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën e lartcekur.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 17 tetor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 12 shtator 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
